

1. NJOHURIT E PARA MBI KONTABILITETIN

Shoqëritë tregtare krijohen me qëllim që t'i plotësojnë nevojat e konsumatorëve dhe njëherit të krijojnë mbivlerën, me të cilën do t'i paguajnë punëtorët, shpenzimet tjera dhe pronarët do të përvetësojnë fitimin. Ato paraqiten si njësi ekonomike për shkak se kryejnë një veprimtari afariste, duke shfrytëzuar faktorët e prodhimit (mjetet e punës, kapitalin dhe fuqinë punëtore) krijojnë të mira materiale.

Deri kah mesi i shekullit XX, sistemi informativ i kontabilitetit ka arritur me sukses të funksionojë dhe në mënyrë të pavarur të zhvillohet, në kuadër të ekonomive të caktuara kombëtare dhe kufijve të saj politikë. Por, sot ndryshimet në jetën e përgjithshme shoqëro-ekonomike si dhe kushtet e reja të ekonomizimit në tërë botën janë aq të mëdha që detyrimisht ndikojnë në adaptimin dhe harmonizimin e të gjitha instrumenteve për evidentim.

Kontabiliteti është i rëndësishëm si burim i informatave, të cilat janë të rëndësishme për sjelljen e vendimeve nga ana e shfrytëzuesve të atyre informatave. Andaj mësimi i kësaj discipline do të kërkojë të njihemi me forma të ndryshme të organizimit dhe llojet e aktiviteteve që ato i kryejnë. Do të njihemi me kontabilitetin si formë e komunikimit me ata që në ndonjë formë kanë interes për punën financiare të kompanisë, si dhe me raportet financiare kontabël.

1.1. ÇKA ËSHTË KONTABILITETI ?

Në përditë shumica e njerëzve kontabilitetin e konsiderojnë si një lëmi shumë profesionale të cilën e shfrytëzojnë dhe e kuptojnë vetëm kontabilistët profesional. Por, pothuajse të gjithë njerëzit çdo ditë në ndonjë formë e përdorin "kontabilitetin". Sa herë që paguani faturat e celularit tuaj, të energjisë elektrike, të shërbimeve komunale, sa herë që e barazoni llogarin tuaj bankare, plotësoni formularin mbi të ardhurat vjetore, ju punoni apo përdorni nocione dhe informata kontabël.

Kontabiliteti është art i interpretimit, matjes dhe lidhjes së rezultateve të aktivitetit ekonomik. Kontabiliteti gjithmonë është quajtur si gjuha e afarizmit. Termat sic janë të ardhurat, të hyrat, prona, detyrimet, qarkullimi ditor, fluksi monetar, fitimi, aksionet, dividendat, neto rroga, fitimi, humbja, tatimi mbi vlerën e shtuar, janë vetëm disa shembuj të nocioneve teknike të kontabilitetit që shfrytëzohen në botën afariste. Secili investitor, menaxher dhe sjellës i



vendimeve afariste duhet qartë ti kupton termat dhe shprehjet kontabël në qoftëse dëshiron të mer pjesë dhe të jetë i suksesshëm në bashkësinë afariste.

Fjala kontabilitet rrjedh nga fjala italiane “Contare” që do të thotë llogaris, mbaj llogari, numëroj, bëjë hesap, pra llogarimbajtje. Të gjithë shfrytëzuesit e informatave kontabël dëshirojnë të mbajnë llogari të saktë dhe adekuate të aktivitetit afarist të subjektit ekonomik. Kjo mundësohet nga kontabiliteti nëpërmjet pasqyrit të saktë të të gjitha ndryshimeve (ngjarjeve) ekonomike me të cilat ka të bëjë subjekti ekonomik.

Njohuritë mbi kontabilitetin nuk duhet të kufizohen vetëm tek studentët të cilët e kanë si lëndë kryesore. Secili që është i kyçur në aktivitet ekonomik do të ketë përfitim nga njohja e natyrës, rëndësisë dhe kufizimeve nga informatat kontabël.

1. 2. NOCIONET MBI KONTABILITETIN

Për t'i kuptuar më mirë dhe më qartë qëllimet dhe detyrat e kontabilitetit, së pari, do të japim disa definicione mbi kontabilitetin, që janë dhënë nga autorë të ndryshëm, në periudha të ndryshme kohore ku ka dominuar zhvillime të ndryshme shoqëro-ekonomike. Në këtë rast do të përmendim vetëm disa nga definicionet mbi kontabilitetin:

Instituti Amerikan AICIPA kontabilitetin e definon si art i regjistrimit, i klasifikimit dhe i përmbledhjes në një mënyrë kuptimplote e në vlerë monetare të veprimeve, që janë së paku pjesërisht me karakter financiar, si dhe interpretimit të këtyre rezultateve.¹

Në librin “Kontabiliteti financiar” i Prof.dr. Sotiraq Dhamos, kontabiliteti paraqitet si një proces i vrojtimit, i matjes, i vlerësimit, interpretimit dhe komunikimit të informacionit financiar për qëllime të kontrollit financiar dhe marrjen e vendimeve efektive të drejtimit ekonomik të njësive ekonomike.¹

John Wild thotë se kontabiliteti bën matjen, regjistrimin dhe komunikimin e informacioneve relevante, të besueshme dhe krahasuese të aktiviteteve të një organizate ekonomike.²

Kontabiliteti paraqet metodë speciale për regjistrimin dhe kontrollimin e proceseve dhe ndryshimeve ekonomike që ndodhin në kuadër të një subjekti ekonomik, që janë të shprehura në vlerë, me qëllim që të vihet re se si ato ndryshime ndikojnë në mjete dhe në burimet e tyre, në të ardhurat dhe të dalat, si dhe përcakton rezultatin afarist të atij subjekti ekonomik.³

Sipas Dr. Littleton, roli kryesor i kontabilitetit është që njerëzve t'u mundëson të sjellin nota adekuate për suksesin e subjektit ekonomik, i cili krijohet nga kryerja e shërbimeve të veta dhe njëherit sipas tij, kontabiliteti paraqet zemrën dhe qendrën e strukturës në teorinë e llogaritarisë. Ai thekson se n.q.s gjatë definimit të kontabilitetit nisemi nga qëllimi i tij, atëherë kontabiliteti paraqet metodë ekonomike për përcaktimin e pronës dhe rezultatit nga puna e subjektit ekonomik. Po qe se për definimin e tij nisemi nga aspekti i detyrave të kontabilitetit,

¹ AICP, Committee on Accounting Terminology No.1.

² John Wild, Financial Accounting, 2000, p.4

³ Todor Mirovski, Pojava i razvitok na knjigovodstvoto, Godisnik na Pravno-ekonomskiot fakultet vo Skopje, Shkup, 1956.

atëherë mund të thuhet se kontabiliteti është metodë e mbledhjes, klasifikimit, regjistrimit, ruajtjes dhe njoftimit për ndryshimet ekonomike në pronën e subjektit të caktuar ekonomik.⁴

Autori francez Jean Korre, kur jep definicionin mbi kontabilitetin, ndër të tjera thekson se kontabiliteti paraqet gjuhën e përbashkët të të gjithë pjesëmarrësve në jetën ekonomike.⁵

Profesori i njohur kroat Stevan Kukoleca thekson se kontabiliteti paraqet aktivitet i cili ka për qëllim evidentimin e gjendjes dhe ndryshimeve në pronën e subjekteve ekonomike dhe joekonomike. Evidentimi kryesisht bëhet në tregues vleror dhe rrallë herë në tregues në natyrë.⁶

Sipas një grupi tjetër të autorëve, kontabiliteti është lloj i veçantë i evidencës ekonomike, e cila merret me regjistrimin e proceseve reproduktuese në subjektin ekonomik. Nëpërmjet kontabilitetit ndiqen të gjitha mjetet dhe burimet e tyre, të ardhurat dhe të dalat, si dhe rezultati nga puna e subjektit ekonomik.

Të dhënat kontabël paraqesin burimin themelor jo vetëm për paraqitjen e gjendjes dhe lëvizjen e mjeteve dhe burimeve, por njëherit edhe bazë kryesore për planifikim kontabël, kontroll kontabël, analizës kontabël, informim kontabël, etj.⁷

Kontabiliteti përdor si masë matëse për njësinë monetare. Ai jep pasqyrë për punën e subjektit ekonomik në të kaluarën. Qëllimi përfundimtar i kontabilitetit dhe produkt i saj përfundimtar është pasqyra financiare ku nga më të rëndësishme janë bilanci i gjendjes dhe pasqyra e fitimit, apo humbjes (bilanci i suksesit).


Pra, kur bëhet fjalë për definicionin mbi kontabilitetin, është tepër vështirë të jepen përcaktime më precize dhe gjithëpërfshirëse, mendime dhe sugjerime që do të jenë adekuate për përdorim për të gjitha kohërat dhe në të gjitha hapësirat.

⁴ A.C. Littleton "Structura of Accouting Theory", American Accouting Asociacion, 1967, p.56. (e cituar në Finansisko racunovodstvo, Sovremena administracija, Beograd), 1994.

⁵ Po aty.

⁶ Dr. Stevan Kukoleca: "Organizaciono-poslovni leksikon", Zavod za ekonomske ekspertize, Beograd, 1990.

⁷ Dane Melavc, "Racunovodstvo anas", Moderna organizacija, Kranj, 1989.



Nga definicionet e lartpërmendura mund të nxjerrim këto **konkluzione**:

- Kontabiliteti merret me ngjarjet e ndodhura në biznesi i cili kryhet brenda një subjekti ekonomik, kompanie ose entiteti.
- Kontabiliteti është një shërbim, arti i regjistrimit, duke e klasifikuar, duke e shkurtuar paraqitjen dhe interpretim e ndryshimeve ekonomike në formën e parave të gatshme.

Në bazë të definicioneve dhe konkluzave të lartshënuara, si komponente kyçe mbi definicionin e kontabilitetit janë:

- *Sasiore*- pasi të gjitha ndryshimet ekonomike që ndodhin në kuadër të subjektit ekonomik kontabiliteti i lidh me numra.
- *Financiare*- pasi ndryshimet në kontabilitet fokusohen në aspektin financiar.
- *Shfrytëzimi*- pasi kontabiliteti i shfrytëzon rregullat teorike duke i zbatuar në praktikë.
- *Vendimet*- në bazë të të dhënave dhe informatave të kontabilitetit shpesh herë merren vendime shumë të rëndësishme për ardhmërin e subjektit ekonomik.

Në mënyrë të përgjithshme kontabiliteti është një sistem i organizimit të informacionit financiar në subjektin ekonomik i cili duhet të sigurojë:

- ✓ kapjen e plotë dhe në kohë të të dhënave të shprehura në vlerë për veprimet e kryera,
- ✓ regjistrimi i të gjitha ndryshimeve vlerore që ndodhin në subjektin ekonomik, si dhe
- ✓ dhënia e një tërësie informatash përdoruesve të interesuar.

1.2.1. Objekt i regjistrimit

Si çdo lëndë tjetër, që ka objektin e saj të veprimit, po ashtu edhe kontabiliteti ka objektin e tij. Objekt i regjistrimit në kontabilitet janë ato veprime ekonomike të cilat i plotësojnë këto katër kushte, përkatësisht:

1. Ngjarje të kaluara afariste, ngjarje që veç kanë ndodhur;

2. Që të argumentohen me një dokument të besueshëm kontabël;

3. Efektet e ngjarjeve ekonomike të cilat mund të shprehen në para;

4. Drejtpërdrejtë të ndikojë në ndryshimet e mjeteve (aseteve), burimeve të mjeteve, të ardhurat, shpenzimet dhe rezultateve nga puna.

Lëndë e parë për kontabilitetin janë të dhënat mbi aktivitetin ekonomik të njësisë përkatëse ekonomike, ai përgatit të dhëna për procesin e planifikimit, kontrollit dhe vlerësimit të subjektit ekonomik.


1.3. ZHVILLIMI HISTORIK I KONTABILITETIT

Kontabiliteti paraqet një funksion i nevojshëm për të gjitha subjektet ekonomike bashkëkohore. Gjatë zhvillimit historik të shoqërisë e në veçanti të veprimtarive ekonomike është paraqitur nevoja e ndjekjes dhe regjistrimit të ndryshimeve të faktorëve kryesorë në procesin e prodhimit dhe nxjerjen e rezultatit nga aktiviteti i subjekteve ekonomike. Gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit ekonomik, para kontabilitetit janë parashtruar objekte dhe nevoja të ndryshme, të cilat njëkohësisht kanë kërkuar qasje dhe metoda të ndryshme më të përsosura në mbajtjen dhe udhëheqjen e kontabilitetit në suazat e një subjekti ekonomik.

Gjurmët e mbajtjes së evidencës hasen shumë e herët, që në kohën e shoqërisë së parë primitive, ku është mbajtur një evidencë sado e thjeshtë mbi mjetet e përbashkëta. Historia e shënimeve kontabël fillon që kur njerëzit mësuuan të regjistrojnë aktivitetet e tyre ekonomike. Format e shënimeve të thjeshta i hasim që në vitin 3600 para erës së re. Këto shënime i hasim që nga koha e civilizimit në Egjiptin e vjetër (në qytetin El-Kaba, i cili ka ekzistuar 3000 vite para

erës së re, është gjetur vizatim, ku një njeri qëndron ulur dhe e shënon numrin e thasëve me grurë që futet në hambarë).


Është vërtetuar se në Babilonin e vjetër, me zhvillimin e tregëtisë dhe huadhënjes, është mbajtur evidencë, pasi në ligjin e Hamurabit, i sjellur 2000 viteve para erës së re, është theksuar se tregtarët janë të detyruar të mbajnë një evidencë. Evidenca është e njohur edhe në Mesopotami, e cila është mbajtur në të ashtu quajtura “libra të argjilit”. Gjurmë të mbajtjes së evidencës hasim edhe në Kinën e lashtë, pastaj te popujt si Fenikasit, Asirikët, Hebrenjt, etj., ku shënimet janë mbajtur edhe për nevojat shtetërore. Evidenca u paraqit që nga momenti kur ata patën nevojë të mbanin shënime mbi prodhimet e tyre agrokulturore, të aktiviteteve të tyre tregtare, mbi pasurinë e ushtrisë, të mbretërve etj. Që në lashtësi atë kohë realizoheshin regjistrime mbi aktivitetet ekonomike, megjithëse ato shënime ishin elementare.



Në Greqinë antike, evidenca ka qenë e përhapur tek manastiret, të cilat kanë disponuar pasuri të madhe dhe kanë dhënë hua me interes. Është gjetur një llogari e cila daton që nga shek.V i erës sonë, me shënime mbi të ardhurat dhe shpenzimet e manastirit. Me zhvillimin e sistemit bankar në Greqi paraqiten edhe librat e kontabilitetit, ndër të cilat si më të njohura janë: “efemeride” (një lloj i ditarit) dhe “trapezitika” një lloj i saldo kontove.

Në Romën e vjetër evidenca ka qenë e bartur nga Greqia antike dhe është përhapur, veçanërisht me zhvillimin e forcave prodhuese, këmbimin e mallrave si dhe pas krijimit të bankave. Me dhënje të huave janë marrë shtresa të ndryshme shoqërore, duke filluar që nga sklavopronarët e pasur e deri tek filozofët e njohur. Për huat e dhëna dhe afatin e kthimit të tyre është mbajtur libri i ashtuquajtur “liber kalendari”. Po ashtu është mbajtur edhe një libër me emrin “adversaria”, i cili ka pasur karakter memorial. Nga ky libër janë bartur të dhëna në librin tjetër “codex accepti et expensi” e cila ka pasur karakter të raportit të arkës (libri i pagesave dhe

arkëtimeve). Këto shënime veçanërisht janë mbajtur për nevojat personale, të tatimit, etj., të cilat shënime janë mbajtur mbi papirus dhe karakterizohen me një josistematizim, të pakompletuara për njësinë konkrete. Kontabiliteti i thjeshtë është përmendur edhe në librat e shenjtë si Bibla dhe Kurani.



Lirisht mund të theksohet se shtetet antike kanë përdorur evidencën dhe vënd më të rëndësishëm ka pasur evidenca e mardhënjeve kreditore. Evidencat së pari janë shënuar në gurë, pllaka, pastaj në dru, në pllaka argjili, fletëve nga druri, pergamentë dhe në mjete tjera, deri tek përdorimi i letrës, e cila mendohet se është zbuluar në Kinë pothuajse 1000 vite para erës së re, ndërsa është bartë në Europë në shek. VII nëpërmjet Arapëve.

Në shoqërinë feudale evidenca nuk ka qenë shumë e zhvilluar, me përjashtim të manastireve, të cilët në atë kohë dispononin pasuri të konsiderueshme. Toma Akvinski ka bërë shënimin e të gjitha ndryshimeve dhe ngjarjeve që kanë ndodhur në pronën e kishës, ku ai ka shërbyer. Në shekullin e XII janë lajmëruar numrat arab, ndërsa në shek. XV është zbuluar shtypshkronja e parë në Gutemberg, zbulime të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e shpejtë të kontabilitetit.

Me zhvillimin e shoqërisë, kulturës, artit, shkencës dhe ekonomisë në periudhën e Rilindjes u mundësua edhe zhvillimi i kontabilitetit. Libri i parë i shkruar mbi kontabilitetin e dyfishtë është libri i kroatit Benedikt Kotruljevic nga Dubrovniku, njëri nga tregtarët më të pasur të Mesdheut. Libri “Mbi tregtinë dhe tregtarin e përkryer” është shkruar në vitin 1458, por nuk është botuar gjer në vitin 1573. Në të shënohen të dhëna mbi tregtarët e Mesdheut, mënyrat e tregtimit, sjellja e tregtarëve, librat e tyre, pastaj fletë mbi rregullsinë dhe azhuritetin, etj.



Në vitin 1494 është botuar libri i Luca Pacioli, „*Suma de arithmetica, geometrika, proportioni et proportionalita*“, dhe ai llogaritet si themelues apo “baba” i kontabilitetit të dyfishtë, ku autori formuloi parimet bazë të regjistrimit të dyfishtë. Ai bëri sistematizimin e ndryshimeve kontabël dhe sqaroi kontabilitetin e dyfishtë $\sum D = \sum K$.

Në librat afarist i ka futur edhe emrat e blerësve dhe furnitorëve, por edhe përshkrimin e llojit të

mallit, njësinë matëse, çmimin, mënyrën e pagesës etj. Më tej ai thekson se kur paraja pranohet ose paguhet duhet të shënohet lloji i valutës dhe kursi i tij dhe sugjeron që në periudha të caktuara kohore mbylljen e librave dhe llogaritjen e profitit ku një herit thekson se "në fund të çdo viti është mirë që gjithmonë të mbyllet librat e veçanërisht n.q.s jeni në ortakëri me të tjerët. Llogaritë e shpeshta kontabël bëhen për shoqëri të gjatë".

Në shekullin e XVII (në vitin 1605) u bë përllogaritja e parë vjetore e rezultatit, (fitimi ose humbja), nga matematicienti holandez Simon Stevin. Ndërsa në vitin 1693 francezi Jacques Savery e bëri përshkrimin e bilancit dhe raportin mbi fitimin në çdo dy vite.

Më pas, kah fundi i shek. XVII dhe fillimi i shek. XVIII ndodhi revolucioni industrial, që pati si pasojë zhvillimin e hovshëm të ekonomisë, zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare, (nëpërmjet harmonizimit të legjislacionit), paraqitja e aktiveve të qëndrueshme sipas kostos furnizuese, rivlerësimi i mjeteve (aktiveve), amortizimi sipas metodës funksionale, me çka u mundësua një zhvillim shumë i shpejtë i kontabilitetit, ku konceptet, metodat, teknikat e regjistrimit kontabël janë zhvilluar dhe përmirësuar vazhdimisht.

Në fund të shek. XVII dhe fillim të shek.XVIII u bë harmonizimi i rregullave ligjore në fushën e kontabilitetit. Po në këtë shekull në Skotlandë dhe Angli u aplikua kontabiliteti publik dhe u formuan shoqatat profesionale të kontabilistëve. Në vitin 1887 në SHBA u themelua AAPA-Shoqata amerikane të kontabilistëve publik, ndërsa në vitin 1896 lindi profesioni: kontabiliteti profesional, (CPA). Në Nju Jork në vitin 1900 u hap shkolla për tregti, kontabilitet dhe financa.

Shek. XX e karakterizon themelimi dhe zhvillimi i madh i shoqërive aksionare që patën ndikim të madh në zhvillimin gjithëpërfshirës të kontabilitetit, si profesion dhe lëmi e veçantë. Max Weber kështu e sqaron organizimin racional të ndërmarrjeve moderne kapitaliste: "dy janë faktorë kryesorë: ndarjen e ndërmarrjes nga pronarët e tyre dhe kontabiliteti racional". Me revolucionin informatikë u mundësua rritja e tregjeve financiare, harmonizimi i rregullave legjislative dhe praktika e informimit. Fundin e shek. XX dhe fillimin e shek. XXI e karakterizon procesi i globalizimit të ekonomisë botërore, që njëherit parashtron nevojën për një harmonizim të përgjithshëm ligjor.

Nga e gjithë ajo që u tha më lartë, historikun e zhvillimit të kontabilitetit, në pika të shkurtra do ta paraqitnim kështu:

Tabela nr.1. Zhvillimi historik i kontabilitetit

Vendi	Periudha	Veprimet
Egjipt (El-Kaba)	vitin 3600 deri në vitin 500 para erës së re	është gjetur vizatim, ku një njeri rri ulur dhe e shënon numrin e thasëve me grurë që futet në hambarë. Shënimet i mbajtën për nevojat e shtetit.
Vavilonia e vjetër	2000 viteve para erës së re	Ligji i Hamurabit ka theksuar se tregtarët janë të detyruar të mbajnë një lloj të evidencës.
Mesopotani, Kinë, Fenikasit, Asirikët, Hebrejt	Viti 2000 deri në vitin 300 para erës së re	Evidenca është mbajtur në të ashtu quajtura “libra të argjilit”. Shënimet, po ashtu i mbajtën për nevojat e shtetit.
Greqia antike	Shek. V i erës së re	Evidenca ka qenë e përhapur tek manastiret dhe me zhvillimin e sistemit bankar në Greqi paraqiten edhe librat e kontabilitetit: “efemeride” dhe “trapezitika”.
Roma e vjetër		Për huat e dhëna dhe afatin e kthimit të tyre është mbajtur libri “liber kalendarii” pasatj “adversaria”, dhe “codex accepti et expensi”. Evidenca e pasurisë është mbajtur për nevojat e tatimit.
Feudalizëm		Toma Akvinski ka bërë shënimin e të gjitha ndryshimeve dhe ngjarjeve që kanë ndodhur në pronën e kishës ku ai ka shërbyer.
Benedikt Kotruljevic	1458 u botua në vitin 1573	Shkroi librin e parë mbi kontabilitetin e dyfishtë
Luca Pacioli	në vitin 1494	Boton librin „Suma de arithmetica, geometrika, proportioni et proportionalita“, dhe ai llogaritet si themelues apo “baba” i kontabilitetit të dyfishtë.
Holandë	Shekullin e XVII	Matematicienti Simon Stevin bënë përlllogaritjen e parë vjetore të rezultatit afarist.
Francë	1693	Jacques Savery e bëri përshkrimin e bilancit dhe raportin mbi fitimin pas çdo dy viti.
	Në fund të shek. XVII dhe fillim të shek. XVIII	Bëhet harmonizimi i rregullave ligjore në fushën e kontabilitetit
Skotlandë dhe Angli	shek. XVIII	Aplikohet kontabiliteti publik dhe formohen shoqatat profesionale të kontabilistëve.

SHBA	Viti 1887	U themelua AAPA-shoqata amerikane të kontabilistëve publik.
SHBA	Viti 1896	Lindi profesioni i kontabiliteti profesional, (CPA)
SHBA(Nju Jork)	Viti 1900	U hap shkolla për tregti, kontabilitet dhe financa.
	Shek. XX	E karakterizon themelimi dhe zhvillimi i madh i shoqërive aksionare, procesi i globalizimit që njëherit parashtron edhe nevojën për një harmonizim të përgjithshëm ligjor.

Kryerja e detyrës së subjekteve ekonomike në masë të madhe varet nga informatat kontabël. Këto informata ju ndihmojnë menaxherëve, në situata dhe në momente të ndryshme, të sjellin vendime afariste racionale për zgjidhjen e suksesshme të problemeve dhe për arritjen e profitit më të lartë. Kontabiliteti, nëpërmjet planifikimit, kontrollit, analizës etj. si dhe nëpërmjet përpunimit kompjuterik, në kushte bashkëkohore të veprimtarisë, bëhet instrument shumë i rëndësishëm për udhëheqje efektive me subjektin ekonomik.

1.3.1. Shkollat kryesore të kontabilitetit

Që nga momenti i paraqitjes së kontabilitetit deri më ditët e sotme, kontabiliteti si sistem praktik dhe teorik ka pasur një zhvillim të hovshëm. Zhvillimi i kontabilitetit, si sistem i dhënjes së informacioneve, është varur nga zhvillimi ekonomik, politik, kulturor, arsimor e social i vendeve përkatëse por, njëherit edhe kontabiliteti si sistem informacioni ka ndimuar në zhvillimin ekonomik të vendeve të caktuara. Gjatë historikut të kontabilitetit, janë zhvilluar kryesisht dy shkolla kryesore: shkolla anglosaksone dhe shkolla Europiane (kontinentale).

Shkolla anglosaksone- Kontabiliteti organizohet duke u mbështetur *në standarde kontabël* që paraqesin rregulla dhe parime bazë që zbatohen në organizimin e kontabilitetit, nga ana e kontabilistëve, në subjektin ekonomik. Këtu mbisundon fleksibiliteti, thjeshtësia dhe prakticiteti i kontabilitetit dhe shteti nuk ka shumë ndikim në organizimin e mbajtjes dhe prezentimit të evidencës kontabël. Në punën e tyre rreth organizimit të evidencës kontabël, kontabilistët, gëzojnë një liri më të madhe. Zbatim prakti, kjo shkollë, gjen në SHBA, Kanadë, Australi, etj. Evidenca kontabël kryesisht miret me përgaditjen dhe prezentimin e pasqyrave financiare.

Tek këto shtete dominonin ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të themeluara kryesisht nga kapitali familiar, gjë që e orientonte kontabilitetin në ndërtimin e pasqyrave financiare të nevojshme për ndjekjen e aktivitetit të tyre në bazë të rregullave precize dhe dhënjen e informacionit në kohë këtyre kompanive.⁸

Në *shkollën evropiane*- kontabiliteti organizohet sipas *sistemit të përgjithshëm kontabël*. Mënyra dhe rregullat e organizimit përcaktohen në bazë të Ligjit mbi kontabilitetin dhe Planin e përgjithshëm kontabël. Ndikimi i shtetit në organizimin e jetës ekonomike dhe ligjet juridike përcaktuan një rregull të fortë shtetërore mbi mënyrën e mbajtjes të sistemit të kontabilitetit. Zbatim praktik, kjo shkollë, gjen kryesisht tek shtetet evropiane siç janë: Gjermania, Franca, Italia, Austria, etj. Kontabiliteti është i orientuar për qëllime fiskale të shtetit, për mbajtjen e llogarive kombëtare, për mbrojtjen e interesit të kapitalit të kompanive të mëdha si dhe për mbrojtjen e interesit të kreditorëve.

1.4. LËNDA, DETYRAT DHE ROLI I EVIDENCËS KONTABËL

Kontabiliteti është proces i identifikimit, matjes dhe pasqyrimit të informacionit ekonomik në atë mënyrë që ti mundësojë përdoruesit vendimmarrje sa më të mira në bazë të fakteve konkrete. Kontabiliteti nëpërmjet informatave të saja i përcjell dhe evidenton të gjitha ndryshimet që ndodhin në subjektin ekonomik si në mjete ashtu edhe tek burimet e mjeteve, si tek të dalat ashtu edhe tek të ardhurat.

Kontabiliteti ofron informata ditore dhe periodike, për gjendjen dhe lëvizjen e çdo mjeti dhe burimi mjetesh, për çdo shpenzim, për të ardhurat dhe të dalat, si dhe tërësinë e mjeteve dhe burimeve të tyre. Kontabiliteti jep të dhëna për produktivitetin e krijuar në subjektin ekonomik. Në bazë të të dhënave të kontabilitetit vërtetohet rregullsia e përdorimit dhe menaxhimit me mjete, si dhe u ofrohen informata nga karakteri financiar organeve dhe institucioneve jashtë ndërmarrjes. Nëpërmjet informatave kontabël, u lehtësohet dhe shpejtohet puna organeve vendimmarrëse.

⁸ Shefket Jakupi, Elez Osmani, "Bazat e kontabilitetit", Ulqin, 2012, faq.22.

1.4.1. Lënda e evidencës kontabël

Lënda e evidencës kontabël është evidenca e të gjitha ndryshimeve që ndodhin në subjektin ekonomik të shprehura në vlerë. Numri dhe lloji i ndryshimeve në një subjekt ekonomik varet nga natyra e vetë subjektit. Ashtu si në një subjekt prodhues që puna përbëhet nga fitimi i mjeteve monetare, nga shpenzimi i tyre për furnizimin e materialeve, dhënia e materialeve në procesin prodhues, fitimi i produkteve të gatshme nga ai proces, fitimi i parave nga shitja e produkteve të gatshme si dhe nga ndryshimet e tjera që ndikojnë në ndryshimin e madhësisë së mjeteve dhe burimeve të mjeteve.

1.4.2. Detyrat e evidencës kontabël

Detyrat e evidencës kontabël janë evidenca e atyre veprimeve ekonomike që kanë si pasojë ndryshimin e strukturës në mjete, në burimet e tyre, në të ardhurat, në të dalat dhe kapitalin.

Detyrat që duhen të realizohen me regjistrimin e evidencës kontabël janë të ndryshme, ku si më të rëndësishme janë:

- gjatë regjistrimit të mjeteve dhe burimeve të mjeteve mundësohet kontrollimi respektivisht mundësohet që të vërtetohet saktësisht sasia e mjeteve që subjekti ekonomik duhet ti ketë në dispozicion, apo përcaktimi i gjendjes së pasurisë dhe kapitalit në ditë të caktuar,
- me ndihmën e evidencës kontabël ndiqet puna e subjektit ekonomik dhe vërtetohet plotësimi i detyrës dhe përcaktimi i rezultatit financiar. Pra, kontabiliteti ka për detyrë që të përcaktojë vlerën furnizuese, vlerën prodhuese, vlerën shitëse të produkteve të gatshme si dhe lartësinë e rezultatit financiar,
- ti përcaktojë shpenzimet gjatë punës, koston e materialeve, mallrave dhe koston e produkteve të gatshme, etj. Kjo kryhet me qëllim që të vërtetohet pse është shpenzuar më tepër, respektivisht a ka pasur më tepër apo më pak shpenzime pra, të përcaktohet ekonomizimi i punës,
- tu japin informata dhe të dhëna pronarëve dhe organeve udhëheqëse të subjektit ekonomik që ta drejtojnë sa më mirë punën, si dhe tu japin informatat e nevojshme organeve dhe të interesuarve të tjerë jashtë subjektit ekonomik,

- të mbledhë informacionet mbi ngjarjet e ndodhura, mbledhjen e dokumenteve të vlefshme që vërtetojnë ndryshimet në biznes.

1.4.3. Roli i evidencës kontabël

Kontabiliteti dhe informatat kontabël janë tepër të rëndësishme për menaxhimin e subjekteve ekonomike në veçanti dhe të shoqërisë në tërësi. Është tepër i nevojshëm për të gjithë subjektet ekonomike që miren me aktivitet ekonomik. Roli i evidencës kontabël është: instrument informativ, kujtesë e shkruar dhe e dokumentuar, dokumentacion për përpilimin e pasqyrave financiare dhe referim për pasqyrën fiskale.

Instrument informativ- të dhënat e kontabilitetit u shërbejnë udhëheqësve të kompanive për marrjen e vendimeve ekonomike, pasi ajo grumbullon, regjistron, rregullon, përpunon dhe paraqet tërësinë e informacioneve që dalin nga marrëdhëniet e ndërmarrjes me subjektet e treta. Kontabiliteti me anë të regjistrimit pasqyron ndërrimet ekonomike të së kaluarës, të tashmes dhe siguron një parashikim të saktë për të ardhmen.


Kujtesa e shkruar dhe e dokumentuar – tërësia e ndërrimeve ekonomike që kryhen në një kompani regjistrohen në bazë të dokumenteve fillestare (si fatura, fletë dërgesa, ekstrakti i bankave, arka pranon dhe paguar, raporti i arkës etj.) që kanë një vlerë prove dhe besueshmërie të madhe. Informacioni kontabël, i dokumentuar në mënyrë të përshtatshme, shërben si bazë për kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm dhe përbënë bazën e kontrollit zyrtar të llogarive dhe të bilancit kontabël.

Dokumentacion për përpilimin e pasqyrave financiare - Regjistrimet në kontabilitet bëhen me qëllim që të plotësohen në mënyrë të saktë pasqyrat financiare. Saktësia e tyre është e kushtëzuar nga regjistrimet e sakta dhe korrekte të kontabilitetit. Nuk mund të përpilohen pasqyra financiare të vërteta dhe të sakta nëse nuk janë bërë në mënyrë të saktë regjistrimet kontabël.

Të dhënat nga kontabiliteti janë bazë, për organet e administratës financiare shtetërore, për sasinë e tatimit dhe kontributeve që duhet të paguhet nga një subjekt në llogari të buxhetit shtetëror. Kjo e bën akoma më të domosdoshme një referim më të saktë dhe preciz të regjistrimeve në kontabilitet.

Sipas gjithë këtyre objektivat e kontabilitetit janë ngritja e besimit në regjistrimin e plotë të ndryshimeve ekonomike, në pasqyrat e qarta dhe të sakta financiare dhe në raportet vjetore të publikuara nga subjektet ekonomike. Kontabiliteti prodhon outpute, duke përdorur inputet dhe proceset për të plotësuar objektivat specifike të drejtimit.

Figura 1. Modeli i funksionimit të sistemit të informacionit të kontabilitetit.




Proceset janë thelbi i sistemit të informacionit kontabël dhe përdoren për të transformuar inputet në outpute për plotësimin e objektivave të sistemit.

1.5. RREGULLAT E KONTABILITETIT

Në historikun e tij të zhvillimit shumëshekullor, duke filluar që nga praktika kontabël deri te teoria kontabël, nëpër periudha të ndryshme kohore, janë përvetësuar parime dhe rregulla të

ndryshme kontabël, në lidhje me mënyrën e evidentimit, teknikën e kontimit, pasqyrimin dhe prezantimin e rezultateve kontabël. Mbjajtja shumëvjeçare e kontabilitetit në subjektet ekonomike, njëherit ka mundësuar përsosjen, thjeshtësimin dhe racionalizimin e tij. Përdorimi i saktë i rregullave dhe parimeve të kontabilitetit garanton kryerjen me sukses të detyrave kontabël.

Si rregulla më kryesore të kontabilitetit mund të veçohen:



DOKUMENTIMI- paraqet rregullin e përgjithshëm të përvetësuar në praktikën e kontabilitetit. Pa dokumente të rregullta dhe sipas standardeve të caktuara nuk është e lejuar që të kontohet (regjistrohet). Kontimi me dokumente pa standarde të caktuara dhe me shënime jo të plota mundë të sjellë edhe vendime të gabuara, ndërsa regjistrimi pa dokument është i palejueshëm dhe llogaritet si falsifikim. Për përcaktimin e rregullsisë së dokumenteve në subjektet ekonomike ekziston njësi e veçantë organizative.

PEDANTËRIA (rregullia)- do të thotë evidentim pedant, rregullim dhe ruajtje pedante e shënimeve kontabël të subjektit ekonomik. Gabimet eventuale nuk guxojnë të fshihen me mjete kimike apo mos shikohet gabimi i bërë, por në rast se është bërë gabim fshirja duhet të bëhet në atë mënyrë që të lexohet ajo që është fshirë, psh. (56-800) 58.600

PASQYRIMI –është rregull e kontabilitetit me aplikimin e së cilës mundësohet punë e shpejtë dhe e lehtë në kryerjen e punëve kontabël. Po ashtu sipas kësaj rregulle regjistrimet dhe pasqyrimet e ndryshme kontabël duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe jo të komplikuar.

AZHURITETI- informatat janë të përdorshme vetëm n.q.s janë në kohën e duhur. Azhuriteti nënkupton formulimin e dokumentit, regjistrimin e saktë dhe në kohë të tij. Azhuriteti nuk nënkupton vetëm regjistrimin në ditar dhe në konto por një herit nënkupton edhe formimin me kohë të dokumenteve. Afati për regjistrimin e ndryshimeve kontabël është 8 ditë që nga kur kanë ndodhur.

LIDHSHMËRIA- mundëson lidhshmërinë e lehtë reciproke të regjistrimeve në disa dokumente kontabël, siç janë: urdhëresa për regjistrim, ditar dhe konto sintetike. Çdo dokument duhet të shënohet se në cilën faqe të ditarit është regjistruar, si dhe ku është bartur. Ky rregull na mundëson njëherit që më lehtë të kryejmë kontrole të ndryshme si në kontot analitike ashtu edhe në ato sintetike.

PLOTËSIA- do të thotë që të përfshijë të gjitha ndryshimet në kontabilitet dhe duhet të jenë të evidentuara, respektivisht të kontuara në periudhën e duhur kohore. Nuk guxojmë me vetëdije apo pa të disa dokumente të regjistrojmë e disa tjera të mos i regjistrojmë. Mos regjistrimi i të gjitha dokumenteve kontabël detyrimisht si pasojë ka edhe paraqitjen joreale të rezultatit financiar (humbjes apo fitimit).

KRONOLOGJIA- dokumentet për regjistrim duhet të formohen sipas datës së tyre kronologjike, sipas datës kur kanë ndodhur, apo sipas numrit të tyre rendor.

KONTROLLIMI- kontabiliteti duhet të jetë i organizuar në atë mënyrë që saktësia e çdo dokumenti mund të kontrollohet përsëri pa probleme dhe pa humbje kohe.

Me zhvillimin e ekonomisë, njëherit edhe të kontabilitetit, rregullat kontabël ndryshojnë, si për nga rëndësia e tyre ashtu edhe për nga aplikimi i tyre. Përveç rregullave të lartpërmendura

kontabël, ekzistojnë edhe rregulla tjera siç janë: rregulla e ekonomizimit, kontinuitetit, rregulla konzistente, relevante dhe rregulla të njëllojshmërisë, rregulla të publikimit, etj.

1.6. PARIMET E KONTABILITETIT

Parimi, si nocion, nënkupton një ligj ose rregull i përgjithshëm, në bazë të të cilit duhet të vepohet apo punohet në praktikë. Përdorimi i rregullt dhe adekuat i rregullave dhe parimeve në kontabilitet mundëson një punë të lehtë dhe të saktë, si gjatë kontimit apo regjistrimit të ndryshimeve në subjektin ekonomik, ashtu edhe gjatë formulimit dhe prezantimit të pasqyrave financiare. Kontabiliteti ka për detyrë të sigurojë informacion i cili do të jetë lehtësisht i përdorur nga të gjithë shfrytëzuesit e informatave kontabël.

Parimet e kontabilitetit janë:

- **Parime të përgjithshme** dhe
- **Parime specifike**

Parimet e përgjithshme janë supozimet bazë, konceptet dhe udhëzuesit bazë që duhet të zbatohen për përgatitjen e pasqyrave financiare. Parimet e përgjithshme bazohen në praktikatat kontabël të përdorura për një kohë të gjatë.

Parimet specifike janë rregulla të drejtuara dhe të përdorura në raportimin nga njësi ekonomike e veprimeve dhe ngjarjeve të njësisë ekonomike. Ndërsa parimet specifike lindin zakonisht nga rregullimi i grupeve të caktuara të biznesit prej autoritetit rregullator.⁹

Pavarësisht se kush është përdorues i informatave kontabël, ai duhet të plotësojë disa parime, siç janë:

Parimi i përkatësisë- nënkupton që informacioni kontabël duhet të jetë në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e shfrytëzuesve të informacionit kontabël. Përdoruesit, në bazë të këtyre informatave, duhet të jenë në gjendje të sjellin vendime të rëndësishme afariste për subjektin e caktuar ekonomik.

Parimi i verifikueshmërisë- nënkupton parimin në bazë të të cilit kontabiliteti duhet të punojë dhe veprojë sipas parimeve dhe procedurave të caktuara dhe të mbështetura në ligje dhe

⁹ Sotiraq Dhama, Parimet bazë të kontabilitetit, Tiranë, viti 2010, faq.57.

përdoruesit e informatave kontabël, gjatë përdorimit të tyre, të kenë mundësi tu referohen ligjeve të caktuara.

Parimi i paanshmërisë- nënkupton parim kontabël të tillë që informacioni kontabël duhet të jetë i paanshëm. Ky parim nuk lejon që informatat ti përshtaten personave apo grupeve të caktuara të interesit.

Parimi i matshmërisë- nënkupton parim kontabël ku të dhënat kontabël të mund të shprehen në numra (vlerë) si dhe në tregues të tjerë të matshëm. Qëllimi është që gjatë përdorimit të këtyre informatave kontabël të mos krijohen paqartësi gjatë përdorimit apo kontrollit të tyre.

Autorë të tjerë parimet kryesore të kontabilitetit i ndajnë në: prona dhe parimi i evidentimit të dyanshëm (aktivi=pasivin), parimi i dualitetit në përfshirjen e ndryshimeve në pronë; parimi i njësisë afariste në kuptimin e njësisë kontabël, respektivisht në tërësinë bilansore; parimi i punës në kontinuitet (vazhdimësi) i njësisë afariste; parimi i të shprehurit vlerorë të të dhënave mbi pronën e njësisë afariste; parimi i vlerësimit në bazë të shpenzimeve faktike; parimi i objektivitetit, i paanshmërisë dhe sigurisë të të dhënave kontabël për pronën e njësisë afariste.¹⁰

1.7. FORMAT E ORGANIZIMIT TË BIZNESIT

Kontabiliteti është i lidhur kryesisht me veprimtarin afariste të njësisë ekonomike. Me njësi ekonomike nënkuptojmë një grup njerëzish të organizuar, në një formë të caktuar, për të realizuar një detyrë konkrete, në mënyrë ta pavarur, brenda aktivitetit ekonomik të shoqërisë. Varësisht nga qëllimi i krijimit të tyre dallojmë dy tipe:

-njësi ekonomike që kanë për qëllim përfundimtar fitimin (organizatat biznesore). Organizatat e biznesit nuk veprojnë si organizatë e shkëputur, por në lidhje dhe bashëveprim të ndërsjelltë me njësit tjera, dhe

-njësi joekonomike që nuk kanë qëllim përfundimtar fitimin, por kryejnë aktivitete publike (organizata jobiznesore, jofitimprurëse). Organizatat jobiznesore mirren me shëndetësi, edukim, transport, aktivitete kulturore, shërbime juridike etj. Organizata të tilla janë: spitalet publike, shkollat publike, transporti publik, etj. Evidenca kontabël tek këto organizata është tepër e

¹⁰ G. Ilic, R. Radovanovic, Finansijsko racunovodstvo, Beograd, 1994, f. 12.

rëndësishme dhe shpesh ky kontabilitet njihet si kontabiliteti publik ose kontabiliteti i organizatave jofitim prurëse.

Në literaturën ekonomike dhe atë juridike theksohen tri forma kryesore të organizimit të biznesit:



Biznesi me një pronar – zotërohet nga një person i cili ka të drejtën e kontrollit të plotë mbi biznesin e tij dhe njëkohësisht ka përgjegjësinë e plote për biznesin. Pronari ka të drejtën e marrjes së fitimit dhe njëherit ka detyrime që krijohen nga afarizmi i biznesit. Ky lloj i biznesit karakterizohet me shpenzime më të ulta ligjore për të filluar aktivitetin biznesor. Pronari i firmës në rast të mbylljes së biznesit, pasi ti shlyen të gjitha detyrimet, pjesën që ngel mund ta përvetëson. Po qe se ky kapital nuk mjafton për shlyerjen e detyrimeve, atëherë atij, pasuria personale, nga ana e kreditorëve, mund ti blokohet, (toka, shtëpia, parat e kursyera, automjetet, pasuria tjetër e patundshme etj.). Pra, pronari ka përgjegjësi të pakufizuar.

Bashkëpronësia – për të ekzistuar ky lloj i biznesit duhet të ekzistoj marrëveshja në mes partnerëve për të zhvilluar biznes së bashku. Për të regjistruar një biznes të tillë duhet patur këto elemente: emri, mbiemri, vendbanimi, nënshtetësia e bashkëpjesëmarrësve si dhe firma dhe selia e personit juridik. Po ashtu duhet të theksohen edhe lloji i veprimtarisë, kohëzgjatja, shuma e lartësisë së çdo pjesëmarrësi, të drejtat dhe obligimet si dhe përfaqësimi i shoqërisë.

Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëria tregtare është personi juridik që krijohet me aktin mbi themelimin ose me kontratën ndërmjet dy ose më shumë themeluesve të shoqërisë, që bashkojnë kapitalin me qëllim që në kuadër të të njëjtës firmë të ushtrojnë në mënyrë të pavarur dhe të përherëshme veprimtarinë ekonomike për realizimin e fitimit.

Sipas formës, shoqëritë tregtare në R.Maqedonisë ndahen në: shoqëri tregtare publike, shoqëri komandite, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionare dhe shoqëri komandite

e aksionare. SHT themelohen për ushtrimin e të gjitha veprimtarive me përjashtim të veprimtarive bankare, tregtisë së letrave me vlerë, sigurimit dhe mbrojtjes.

SHT janë persona juridik që nga dita e regjistrimit në regjistrin tregtar. Pasurinë që e shfrytëzojnë SHT është e partnerëve. Investimi i përbashkët shprehet në të holla dhe paraqet kapitalin kryesor të SHT ose kryegjëja bazë. Themelues të SHT mundë të jenë persona fizik dhe juridik si të vendit ashtu edhe të huaj. Personi fizik për të themeluar SHT duhet të ketë aftësi afariste për të lidhur kontratë. SHT mund të themelohen në afat të caktuar dhe në afat të pacaktuar.

Korporatat – është njësi biznesore që ligjërisht është e ndarë nga aksionerët (pronarët) e saj. Shoqëria lëshon certifikata të pronësisë ose aksione në këmbim të secilit kontribut, dhe aksionerët janë të lirë të bartin interesin e tyre pronësor ose t’ua shesin aksionet e tyre personave të tjerë në çdo kohë. Aksionarët nuk kontrollojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë afarizmin e shoqërisë. Ata zgjedhin bordin e drejtorëve dhe bordi zgjedh menaxherin, i cili mer përsipër që të drejton korporatën.

1.8. PËRDORUESIT E INFORMATAVE KONTABËL

Është e rëndësishme të theksohet se nuk mundë të sillen asnjë vendim ekonomik pa informata adekuate kontabël. Kontabiliteti është gjuhë për aktivitete ekonomike dhe secili subjekt ekonomik, pavarësisht nga lloji dhe madhësia, mbështetet në kontabilitetin për vendimmarrje efikase.


Çdo subjekt ekonomik, për t’i kryer detyrat e veta me sukses, përdorë të mirat materiale, monetare dhe njerëzore dhe hyn në marrëdhënie me punonjësit e sajë, me shtetin dhe me subjektet e tjera ekonomike. Do të ishte mirë të theksohen përdoruesit e informatave kontabël në bazë të relacioneve të tyre me subjektet ekonomike. Për kontabilitetin dhe informacionin që ai siguron janë të interesuar një numër i madh operatorësh.

Përdoruesit (shfrytëzuesit) e këtij informacioni, në mënyrë të përgjithshme mundë të ndahen në dy grupe kryesore:

-Përdorues të brendshëm të informacioneve kontabël

Përdorues të jashtëm të informacioneve kontabël.

Figura nr.2 Shfrytëzuesit e informatave kontabël



Përdoruesit dhe arsyet e përdorimit të informatave kontabël do ti paraqesim në tabelën e poshtëshënuar.

Tabela nr.2 Shfrytëzuesit e informatave dhe arsyet e shfrytëzimit

SHFRYTËZUESIT E INFORMATAVE	ARSYET E SHFRYTËZIMIT TË INFORMATAVE
UDHËHEQËSIA-MENAXHMENTI	Ndihmë në marrjen e vendimeve afariste
PUNËTORËT	Ndihmë për të kuptuar rrogat dhe rezervimet për fondet pensionale
AKCIONERËT	Ndihmë për vendimmarrje në investime
INVESTITORI	Ndihmë për vendimmarrje në investime
KREDITORËT	Ndihmë për dhënien (aprovimin) e kredive
FURNITORËT	Ndihmë për dhënien e mallit apo shërbimit
SHTETI	Kontrollit të tatm taksave, planifikim
KONKURENCA	Ndihmë për vlerësimin e forcës se konkurrencës dhe dobësive te strategjisë
SHKENCETARËT	Sigurim i të dhënave për kërkim
MEDIAT	Sigurim të dhënave për raportin dhe lajmërimin

Burimi: Ivan Drazic Lutilsky, Osnove Racunovodstva, Zagreb 2002.

Nga tabela nr.2 vërehet se ka një numër të madh të shfrytëzuesve të informatave kontabël. Arsyet e shfrytëzimit të këtyre informatave janë të shumëllojshme.